

# Orientime mbi Shërbimin dhe Veprimtaritë për Rininë.

*Këto parime dhe orientime kanë për qëllim t'i ndihmojnë të rinjtë e të rejat dhe udhëheqësit në moshë madhore teksa këshillohen së bashku mbi planifikimin për mundësi shërbimi kuptimplotë dhe për veprimtari të shëndetshme e argëtuese. Këto parime dhe orientime mund të përdoren gjithashtu si burime në mbledhjet e këshillave në kunjë, lagje dhe për rininë.*

## PARIMET

Veprimtaritë duhet të planifikohen dhe të zbatohen nga udhëheqësit e kuorumeve dhe udhëheqëset e klasave, me përkrahje nga këshilluesit në moshë madhore. Veprimtaritë duhet:

- Ta forcojnë besimin e brezit të ri tek Ati Qielor dhe Biri i Tij, Jezu Krishti, dhe t'i ndihmojnë të rinjtë e të rejat dhe familjet e tyre që të përparojnë përgjatë shtegut të besëlidhjeve ndërsa përballen me sfidat e jetës.
- T'i ndihmojnë të rinjtë dhe të rejat të përmbushin veprën e shpëtimit dhe ekzaltimit (shih *Manuali i Përgjithshëm: Shërbimi në Kishën e Jezu Krishtit të Shenjtorëve të Ditëve të Mëvonshme* [2020], 1.2, [ChurchofJesusChrist.org](http://ChurchofJesusChrist.org)).
- T'u sigurojnë të rinjtë e të rejtë përkrahje dhe përkatësi duke e forcuar unitetin e kuorumeve e të klasave dhe duke ndërtuar marrëdhëniet e tyre me bashkëmoshatarët, udhëheqësit dhe familjarët.
- Të sigurojnë mundësi të drejtpeshuara që të rinjtë e të rejat t'u shërbejnë të tjerëve dhe të zhvillohen nga ana shpirtërore, shoqërore, fizike dhe intelektuale (shih [Luka 2:52](#)).
- Të sigurojnë përvoja që i ndihmojnë të rinjtë dhe të rejat të përgatiten për t'i përmbushur rolet e tyre hyjnore.
- Të ndjekin të gjitha rregulloret e orientimit për garantimin e sigurisë dhe rregulloret e orientimit të tjera nga Kisha (shih [safety.ChurchofJesusChrist.org](http://safety.ChurchofJesusChrist.org)).

## ORIENTIMET

Orientimet vijuese mund të përshtaten sipas rrethanave vendore, nën drejtimin e udhëheqësve vendorë:

- Zhvillojini çdo javë projektet e shërbimit dhe veprimtaritë atje ku është e mundur. Projektet e shërbimit dhe veprimtaritë mund të zhvillohen pak më rrallë, bazuar te nevojat dhe rrethanat e anëtarëve të kuorumeve dhe anëtareve të klasave, por duhet të zhvillohen të paktën një herë në muaj.
- Përgatiteni një kalendar të paktën tre muaj përpara. Kjo do të sigurojë që të planifikohen një larmi e drejtpeshuar veprimtarish, qëllimore dhe sfiduese, bazuar te parimet më lart, për të plotësuar nevojat e anëtarëve të kuorumeve dhe anëtareve të klasave individualisht.
- Kërkoni mundësi që të rinjtë e të rejat të japin shërbim kuptimplotë ndaj individëve, familjeve dhe komunitetit. Merrini parasysh nevojat dhe interesat e çdo anëtar të kuorumeve dhe anëtareve të klasave ndërsa i nxitni ata/o të zhvillohen përtej vetvetes.
- Për shkak se veprimtaritë e ndërthurura me të rinjtë dhe të rejat janë veçanërisht frytdhënëse, zhvillojini çdo muaj atje ku është e mundur. Veprimtaritë e ndërthurura për të rinjtë e të rejat më të rritura në moshë mund të zhvillohen më shpesh.
- Jepuni të rinjtë e të rejtë mundësi që të frekuentojnë konferencat dhe kampet:
  - Të rinjtë e të rejat që mbushin 14 vjeç e lart, do të frekuentojnë çdo dy vjet një konferencë FSJ. Për të rinjtë e të rejat mund të organizohen konferenca dhe rrugëtime si pionierët gjatë viteve kur nuk zhvillohet konferenca FSJ.
  - Kampet për Të Rejat dhe kampet për kuorumet e Priftërisë Aarone mund të zhvillohen çdo vit.
  - Mund të zhvillohen edhe kampe dhe veprimtari shtesë me fjetje. Për të rinjtë, nxiten çdo vit tre deri në gjashtë kampe apo veprimtari shtesë me fjetje, kur është e realizueshme.
- Gjeni ide në lidhje me veprimtari për kuorumet dhe klasat te [ChurchofJesusChrist.org/youth/childrenandyouth/discover](http://ChurchofJesusChrist.org/youth/childrenandyouth/discover). Përdoreni broshurën *Për Forcën e Rinisë (2011)* si një burim për planifikim veprimtarish.

## BURIMET

- *Manuali i Përgjithshëm*, kapitujt 10, 11 dhe 20
- [YoungWomen.ChurchofJesusChrist.org](http://YoungWomen.ChurchofJesusChrist.org)
- [AaronicPriesthoodQuorums.ChurchofJesusChrist.org](http://AaronicPriesthoodQuorums.ChurchofJesusChrist.org)